



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
AGJENCIA E PROKURIMIT PUBLIK
DREJTORIA JURIDIKE DHE E MONITORIMIT TË PROÇEDURAVE

Nr. SSS/5 Prot.

Tiranë, më 03.02. 2023

Të dhëna mbi vendimin e APP Nr. 06 , datë 03 . 02 2023

Agjencia e Prokurimit Publik (në vijim "APP") në mbështetje të nenit 78/1/b të Ligjit Nr.162, datë 23.12.2020 "Për prokurimin publik" (në vijim "LPP") në ushtrim të kompetencave të saj ka nisur procedimin administrativ për përjashtimin e operatorit ekonomik "Eurocommerce Al-Pg" Shpk me NUIS J641036310 nga e drejta për të fituar kontrata publike, për mospërbushje të detyrimeve kontraktuale në realizimin e kontratës me objekt: "Mbikqyrje i objektit: "Mirëmbajtje kanali ujitës dhe ushqyes rezervuari Nr. 1 Stropckë-Rezervuari Pllocë" të lidhur me autoritetin kontraktor, Ndërmarrja e Mirëmbajtjes së Infrastrukturave dhe Punëve Publike pranë Bashkisë Pogradec (në vijim "AK").

Operatori ekonomik ndaj të cilit ka nisur procedimi administrativ (Emri i subjektit, NIPT, adresa): "Eurocommerce Al-Pg" Shpk me NIPT L24616001M, me adresë: Rruga "Qani Çollaku", Pallati Nr.3, Nr. Pasurie N 4/221, Zona Kadastrale 8581, Pogradec, Korçë.

I. Arsyet e fillimit të procedimit administrativ:

Procedimi administrativ ndaj operatorit ekonomik "Eurocommerce Al-Pg" Shpk ka nisur bazuar në kërkesën e AK, i cili me shkresën Nr. 279/15 Prot., datë 23.11.2022, ka kërkuar nga APP përjashtimin e shoqërisë "Eurocommerce Al-Pg" Shpk, nga e drejta për të fituar kontrata publike, për mospërbushje të detyrimeve kontraktuale.

II. Gjetjet:

Në përfundim të procedimit administrativ të nisur, u arrit në konkluzionin se ndodheshim në kushtet e mospërbushjes së detyrimeve kontraktuale, sipas parashikimeve të nenit 78/1/b të LPP ku parashikohet se: "Agjencia e Prokurimit Publik përjashton një operator ekonomik nga e drejta për të fituar kontrata publike, për një periudhë nga 3 muaj deri në 3 vjet për: b) mospërbushje të detyrimeve kontraktuale në kontratat publike, që kanë ndodhur për faj të operatorit ekonomik".

III. Masat:

Me Vendimin Nr 06 datë 03.02 2023, APP ka vendosur të përjashtojë operatorin ekonomik "Eurocommerce Al-Pg" Shpk, me NIPT L24616001M, nga e drejta për të fituar kontrata publike, për 3 (tre) muaj nga hyrja në fuqi e këtij vendimi.